

Komunikatë për Shtyp

Fier, Topojë më 21.05.2010

Qendra Komunitare Seman, ditën e premte datë 21 Maj, 2010, nga ora 10.00 – 12.30, organizoi në ambjentet e saj festimin e “Ditës Kulturore”.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin Kryetari i Qarkut Fier Z. Luan Muçaj, përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit, nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare të Komunës Topojë, banorë të fshatrave përreth, si dhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që ka mundësuar ngritjen e kësaj qëndre.

Aktiviteti u hap nga Zoti Sotir Zarka, Kryetar i Komunës. Zoti Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit përshëndeti pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Më tej aktiviteti vijoi me një program artistik, ekpozitë, ndeshje volejboli ndërmjet shkollave, si dhe me një ndeshje shahu ndërmjet finalistëve në shkallë komune. “Dita Kulturore” vazhdoi me dhënien e disa çmimeve për fituesit. Në fund të aktivitetit u krye edhe pastrimi vullnetar i plazhit të Semanit duke e përgatitur për sezonin e ri veror.

Rikonstruksioni i Qendrës Komunitare të Topojës, që u krye në Maj 2008 në kuadër të projektit “Punët në Komunitet II” është bashkëfinancim i Fondit Shqiptar për Zhvillimim (IDA) dhe Komunës Topojë me vlerë rreth 14 milionë lekë. Kjo qëndër përmban mjedise çlodhëse moderne, sallë interneti si dhe salla trainimi. Tashmë përfituesit e kësaj qëndre janë rreth 180 nxënës dhe 800 banorë të të gjitha moshave.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit i cili ishte i ftuar në këtë aktivitet si donator ka financuar në vite 4 (katër)projekte të tjera me një vlerë totale prej 66. 000.000 lekë. Banorët e kësaj Komune kanë përfituar nga këto financime përmes rehabilitimit të dy ujësjellësave, 1 segmenti rrugor dhe një projekti ujitjeje.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një institucion që nxit një zhvillim social-ekonomik të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Aktualisht FSHZH po realizon projektin “Përmirësimi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri”, projektin e “Ujësjellësave Ruralë ” si dhe projektin “Punët Në Komunitet III”. Këto projekte mundësohen me financimet e Bankës Botërore, Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Banka Gjermane KFË, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), Banka Europiane e Investimeve, Banka Islamike për Zhvillim etj.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që nga krijimi i tij në 1993, ka realizuar 144 projekte infrastrukture në Qarkun e Fierit. Vetëm në rrethin e Fierit janë implementuar deri më sot 70 objekte të infrastrukturës parësore ; prej të cilave 47 janë ndërtime segmentesh rrugore, 19 ujësjellësa, 3 ndërtesa sociale (qendër komunitare, shkolla) dhe një projekt ujitje. Aktualisht FSHZH po investon zbatimin e katër projekteve të infrastrukturës rurale me një vlerë prej 573. 000. 000 lekë.